



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30/04/2020

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.04.2020, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT "Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

nxjerr:

V E N D I M

- II. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT "Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk**, të dt. 27.04.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, kundër Njoftimit **MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të AK –së, të datës 21.04.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 21.04.2020;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

Arsyetim

I. Grupi i Operatorëve Ekonomik NSHT “Viktory Com & Company Murseli shpk & Grand Construction shpk, me datë 27.04.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e autorrugëve” – pj.I-rë: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.04.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se **Grupi i Operatorëve Ekonomik Sh. “Drini Company” sh.p.k & “Berisha Com” sh.p.k.** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar, për arsye se nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues:

Kemi kërkuar: Në bazë të listës tuaj cilat pajisje dëshmi i përgjigjen pajisjeve, kërkojmë sqarime mbi specifikimet teknike dhe dëshmi vetëm për pajisje e lartë shënuara, jo pajisje që nuk janë kërkuar, jo për pajisje shtesë, vetëm për pajisje nga pika a.) deri te pika d.)

Pas pranimit të sqarimit kemi konstatuar: Keni bërë një sqarim me shkrim ku keni specifikuar makinerit e ofruara për këtë tender, nga kontrollimi i dëshmive, përveç që keni bashkangjitur dokumente të pa nevojshme dhe të shumta, të cilat nuk korrespondojnë me kërkesën e pikës 9.1 & 9.2, ju nuk keni arritur të na bindi se keni në dispozicion 4 kamiona me mekanizëm për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës. Me kombinimin e dokumenteve që kemi bërë duke kombinuar lugët dhe hedhësit e kripës, kemi arritur të identifikojmë vetëm 2 kamion me mekanizëm për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës dhe atë duke e marrë të mirëqenë faktin se këto pajisje do të montohen në kamionët që keni ofruar.

Konstatim: Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të cilën e keni dorëzuar përmes platformës së e-prokurimit, nuk është sipas kërkesës së FDT-ës përkatësisht pikës 9.1 & 9.2. në të keni shënuar makineri të pa specifikuar (psh. Tipi, tabelat e regjistrimit etj). Për këtë kemi kërkuar sqarime, nga sqarimi i kërkuar, ju keni sjellë deklaratë dhe listë të pajisjeve për pikën a, b, c dhe d mirëpo prapë nuk keni arritur të dëshmoni zotimin tuaj se posedoni këto makinerinë-pajisjet ashtu siç është kërkuar në pikën 9.1 & 9.2. të FDT-ës.

Tenderi juaj nuk i plotëson kërkesat minimale për mjetet-pajisjet teknike për realizimin e kësaj kontrate.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

